

Strategjia e fuqisë (1:19–23)

Henri Ford e kishte mundësinë të blinte një automobil. Por ai nuk donte që automobili të ishte një privilegj vetëm i njerëzve të pasur. Për ta realizuar këtë, ai zbatoi strategjinë e prodhimit në masë. Ai përdori linjat e prodhimit për të ulur koston e prodhimit, në mënyrë që çmimi i një automobili të ishte i arsyeshëm. Kjo strategji e tij e revolucionarizoi prodhimin e makinave.

Të gjithë përdorim strategji të caktuara për të arritur qëllime të ndryshme si për t'u ngritur në përgjegjësi, për të arritur rezultate maksimale në shkollë apo për të blerë një shtëpi. Disa nga strategjitë që ndërtojmë dhe përdorim janë të suksesshme. Disa nuk janë.

Bibla është një libër strategjie. Ajo paraqet udhëzime (strategji) të ndryshme që njerëzit mund t'i përdorin për të përballuar problemet e jetës. Ajo na tregon se çfarë funksionon dhe çfarë jo. Bibla paraqet strategji që shumë njerëz i kanë provuar në lidhje me familjen, martesën, punën dhe shoqërinë. Në thelbin e saj, Bibla paraqet strategjinë që ka të bëjë me ndërtimin e një marrëdhënieje të drejtë me Perëndinë, të bazuar në bindjen dhe shërbimin ndaj Tij. Një parim i pandryshueshëm i kësaj strategjie është ky: *Njerëzit e Perëndisë i besojnë fuqisë së Tij dhe jo fuqisë së tyre, për të kryer punën e Perëndisë.*

Kujtoni pushtimin e Jerikos, të treguar në Bibël. Kujt do t'i kishte shkuar në mend të marshonte rreth qytetit për shtatë ditë dhe t'i besonte fuqisë së Perëndisë për rrëzimin e mureve, në vend që të

sulmonte qytetin e rrethuar me mur mbrojtës, ashtu si do të vepronte çdo ushtri? Ai ishte plani i betejës së Perëndisë.

Cili gjeneral do të kishte marrë vetëm 300 luftëtarë nga ushtria e tij prej 32 mijë luftëtarësh për të luftuar kundër armiqve të shumtë në numër dhe të armatosur deri në dhëmbë? Perëndia ia dha këtë strategji Gideonit, strategji e bazuar mbi besimin në fuqinë e Perëndisë (Gjykatësit 6:11–16, 8:4–21).

Perëndia pret nga njerëzit e Tij që të besojnë në fuqinë e Tij. Ky është tamam mësimi që jepet te Efesianëve 1:19–23. Këtu jepet strategjia bazë e veprimit të një kisha. A do ta kryejmë punën e Zotit me anë të fuqisë sonë, apo do të veprojmë me anë të fuqisë së Perëndisë?

Pali shkroi:

Dhe t'u ndriçojë sytë e mendjes suaj, që të dini cila është shpresa e thirrjes së tij dhe cilat janë pasuritë e lavdisë së trashëgimisë së tij në shenjtoret, dhe cila është madhështia e jashtëzakonshme e fuqisë së tij ndaj nesh, që besojmë sipas veprimit të forcës së fuqisë së tij, të cilën e vuri në veprim në Krishtin, duke e ringjallur prej së vdekurish dhe duke e vënë të ulej në të djathtën e tij në vendet qiellore, përmbi çdo principatë, pushtet, fuqi, zotërim dhe çdo emër që përmendet jo vetëm në këtë epokë, por edhe në atë të ardhme, dhe vuri çdo gjë nën këmbët e tij, edhe ia dha për krye përmbi çdo gjë kishës, e cila është trupi i tij, plotësia i atij që mbush çdo gjë në të gjithë (1:18–23).

Duke filluar nga vargu 18, Pali u lut që kisha në Efes të kuptonte këto tri të vërteta të padukshme:

(1) shpresën e vetme që u përkiste atyre, (2) trashëgiminë e Perëndisë që u ishte dhënë dhe (3) fuqinë e Perëndisë, me anë të së cilës duhet të vepronin.

Pali përdori shumë fjalë me kuptimin «fuqi» për të theksuar se në Krisht ne marrim fuqinë më të madhe të mundshme. Perëndia dëshiron që çdo kishë lokale të veprojë me anë të fuqisë së Tij (Perëndisë), e cila është pakrahasueshme.

Nuk ka asgjë të keqe nëse bashkësitë lokale organizojnë programe të ndryshme për të ndihmuar banorët e qytetit apo fshatit ku ndodhen. Ne mund të përdorim metoda nga më të ndryshmet për të udhëzuar dhe organizuar njerëzit, në mënyrë që ata të mund t'i përballojnë më mirë situata të caktuara të jetës. Mund t'i ndihmojmë njerëzit të mësojnë se si të bëhen prindër më të mirë, si të kenë marrëdhënie më të mira bashkëshortore, si të vlerësojnë më mirë veten, si ta studiojnë Biblën, si t'ua mësojnë atë të tjerëve dhe si mund t'i shërbejnë më mirë bashkësisë lokale. Mund t'i bëjmë të gjitha këto dhe prapë na mungon diçka në strategjinë kryesore për njerëzit e Perëndisë, veprimi me anë të fuqisë së Perëndisë. Perëndia përpiket të na ndihmojë ta shohim nevojën që kemi për këtë fuqi.

PERËNDIA E FORCON BESIMIN TONË ME FUQINË E TIJ

Pali u lut për *kishën* në Efes që të njihnte fuqinë e Perëndisë, ta merrte atë fuqi dhe ta vinte atë në veprim. Apostulli Pal përmendi tre aspekte të veçanta të fuqisë së Perëndisë, që na inkurajojnë të bëjmë çdo gjë për të përfituar nga ajo fuqi:

1. *Ringjallja e Krishtit prej së vdekurish* (1:20). Kryqi na paraqet shfaqjen më të madhe të *dashurisë* së Perëndisë. Ringjallja e Krishtit na paraqet shfaqjen më të plotë të *fuqisë* së Tij. Fjalët e një kënge na kujtojnë këtë shfaqje të fuqisë hyjnore:

Asnjë fjalë nuk u dëgjua në varr atë ditë,
Vetëm zvarritja e këmbëve të ushtarëve që ruanin
varrin.
Kaloi një ditë, dy ditë, tre ditë,
A ishte e mundur të kishte vdekur?
A ishte e mundur që Ati i Tij ta kishte braktisur,
T'i kishte kthyer shpinën Birit të Tij, duke shpërfillur
mëkatet tona,
Gjithë ferri dukej se pëshpëriste: «Harrojeni! Ai ka
vdekur»
Pastaj Ati pa poshtë nga Biri i Tij dhe tha:
«Çohu, dashuria Ime! Çohu, dashuria Ime!
Varri nuk të mban më.

S'ka më sëmbim vdekjeje, s'ka më vuajtje.
Çohu, çohu, dashuria Ime.»

Jezusi u ngrit. Imgjiloni fuqinë që depërtoi në varr dhe shpërtheu në një shpërthim të jetës së përjetshme. Vetëm Perëndia e ka atë lloj fuqie. Sa budallenj do ishim sikur të mendonim se mund t'ia dilnim pa këtë fuqi!

2. *Lartësimi i Krishit*. Perëndia e demonstroi fuqinë e Tij jo vetëm në ringjalljen e Krishtit, por edhe në lartësimin e Tij. Ai e lartësoi Jezusin «duke e vënë të ulej në të djathtën e tij në vendet qiellore, përmbi çdo principatë, pushtet, fuqi, zotërim dhe çdo emër që përmendet jo vetëm në këtë epokë, por edhe në atë të ardhme» (1:20–21).

Ne themi të vërtetën kur këndojmë këngën «Jezusi është Zot». Ai është Zot. Ai mban një emër që është mbi gjithë emrat. Asnjë fuqi engjëllore, satanike apo njerëzore, nuk mund të krahasohet me fuqinë e Zotit Jezu Krisht. Fuqia e Tij na bën thirrje që të besojmë me të vërtetë në të. Kur ndjekësit e Jezusit ecin sipas fuqisë së Tij, ata nderojnë Atin që qëndron në fronin e përjetësisë.

3. *Epërsia e Jezusit mbi kishën*. Në vargun 22 thuhet: «Dhe vuri çdo gjë nën këmbët e tij, edhe ia dha për krye mbi çdo gjë kishës.» Fuqia e Perëndisë e ka bërë Jezusin Zot absolut mbi botën materiale dhe atë shpirtërore. Jezusi tha: «Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë» (Mateu 28:18).

Ai është Zot mbi gjithçka. Perëndia jo vetëm që e ka bërë Jezusin Zot të Zotave, por «ia dha për krye mbi çdo gjë *kishës*». Me fjalë të tjera, Perëndia At ia ka dhënë Zotin e lavdishëm, Jezus, kishës. Jezusi mbretëron mbi kishën dhe kjo është në të mirën e kishës. Ai qëndron në fron për të bërë të mundur që kisha të bëhet ajo që Perëndia dëshiron që të jetë. Kjo, në vetvete, është një arsye tjetër që bashkësitë të kenë më shumë besim në fuqinë e Perëndisë, sepse vetë Zoti Jezus i është dhënë kishës.

Sipas planit të Perëndisë, vetë besimi ynë duhet të jetë i bazuar në vdekjen, varrosjen dhe në ringjalljen e Zotit Jezus.

PERËNDIA NA FTON TË MARRIM FUQINË NGA E TIJA

Një nga strategjitë bazë të Biblës është kjo: Perëndia dëshiron që njerëzit e Tij të besojnë në fuqinë e Tij dhe jo në fuqinë e tyre. Për sa u përket bashkësive lokale, Perëndia do që ato të veprojnë me anë të fuqisë së Tij dhe na fton të marrim fuqi

nga e Tija.

Kisha (bashkësia) lokale duhet të jetë një shprehje e dukshme e fuqisë së Tij, një shprehje e dukshme e pranisë së Tij dhe një shprehje e dukshme e Zotit Jezus. Kisha lokale duhet t'u ofrojë njerëzve një vend ku ata të takojnë Perëndinë dhe të binden se po jetojnë në mbretërinë e Tij.

Vini re çfarë tha Pali në lidhje me kishën te Efesianëve 1:22–23: Krishti është «kreu përmbi çdo gjë i kishës, e cila është trupi i tij, plotësia e atij që mbush çdo gjë në të gjithë.» Këto vargje përmbajnë dy të vërteta në lidhje me kishën.

1. *Ne jemi «trupi i Tij».* Një lidhje e pazgjidhshme dhe jetësore ekziston midis Jezusit dhe çdo bashkësie lokale. Përfytyroni trupin e njeriut. Ai ka shumë pjesë, duart, veshët, këmbët, mushkëritë, krahët, arteriet, etj. Secila pjesë është e rëndësishme. Kur secila pjesë funksionon, trupi është i shëndetshëm dhe i gjallë.

Ky është plani i Jezusit për kishën e tij. Mos e harroni këtë të vërtetë: *Kisha vepron me anë të fuqisë së Perëndisë, kur funksionon si një trup dhe jo si një organizatë e themeluar dhe e drejtuar nga njerëzit.* Vini re se si tregohet në tabelën e mëposhtme kontrasti midis kishës së vërtetë, trupit të Krishtit dhe «kishës» (organizatës) të ndërtuar dhe udhëhequr nga njerëzit.

Ekziston një ndryshim i madh midis "kishës" si një organizatë dhe kishës së vërtetë, trupit të Krishtit. Shumë dështime dhe probleme të kishave lokale sot vijnë nga fakti se ato funksionojnë më shumë si grupe të organizuara dhe drejtura nga "dituria" njerëzore se sa si trupi i gjallë dhe aktiv i Krishtit.

2. *Ne jemi «plotësia e atij që mbush çdo gjë në të gjithë».* Me fjalë të tjera, Jezusi mbush kishën e Tij. Ndërsa trupi i Krishtit funksionon, ky trup (kisha) bëhet shprehja e plotë e Jezu Krishtit. Kur kjo ndodh, ashtu si ndodhi në shek. I, bota mbarë shikon Krishtin te kisha. Kur kjo ndodh, kisha tërheq vëmendjen e gjithë njerëzve. Njerëzit gjejnë në kishë atë që nuk e gjejnë askund tjetër në botë, Zotin e gjallë, të shprehur fuqishëm në jetët e besimtarëve të Tij.

Thuhet se vendi ku mund të gjejmë shpjegimet më të qarta rreth të vërtetave të Biblës është Bibla vetë. Vini re se si Efesianëve 4:7–16 na shpjegon se strategjia e kishës mund të përmblihet me këto fjalë: «Kisha duhet të veprojë me fuqinë e Perëndisë»:

Po secilit nga ne iu dha hiri sipas masës së dhuntisë së Krishtit. Për ç'ka Shkrimi thotë: «Kur ai u ngjit lart, ai e burgosi burgosjen dhe u dha dhurata njerëzve». Tani kjo: «Ai u ngjit», ç'do të thotë tjetër përveç se ai më parë edhe kishte zbritur në pjesët më të ulëta të dheut? Ai që zbriti është po ai që edhe u ngjit përmbi të gjithë qiejt, për të përmbushur të gjitha gjërat. Dhe ai vetë i dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë dhe të tjerë si barinj e mësues, për përsosjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, të njëjti i përsosur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit, që të mos jemi më foshnja, të lëkundur dhe të transportuar nga çdo erë doktrineje, nga mashtrimi i njerëzve, nga dinakëria e tyre nëpërmjet gënjeshtreve të gabimit, por, duke thënë të vërtetën me dashuri, të rritemi në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti. Prej të cilit gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.

Le të shikojmë zbatimet praktike të këtyre të vërtetave në jetën e kishës: (1) *Për të kënaqur dhe nderuar Perëndinë, kisha duhet të veprojë me anë të fuqisë së Tij.* Perëndia gjithmonë ka insistuar që njerëzit e Tij të veprojnë me anë të fuqisë së Tij dhe jo me anë të fuqisë së tyre. (2) *Për të vepruar me anë të fuqisë së Tij, kisha duhet të funksionojë si një trup.* Për këtë, kristianët duhet të mblidhen së bashku dhe të praktikojnë komandat dhe udhëzimet e Dhjatës së Re që flasin për «njëri-tjetrin». (3) *Për të funksionuar si një trup, kisha duhet t'i japë përparësinë më të madhe jetës së trupit.* Kisha është një komb i ri, një shtresë e re shoqërore. Kjo nuk do të thotë që kristianët tani mund t'i shikojnë të tjerët me shpërfillje (kujtoni që Jezusi vdiq edhe për ta dhe pret që edhe ata të vijnë tek Ai). Por kjo do të thotë që mënyra e tyre e jetesës duhet të jetë tërësisht e re. Kristianët duhet të jetojnë si një trup që vepron me anë të fuqisë së Perëndisë, fuqi që vjen me anë të Jezu Krishtit.

KONKLUZION

Para Luftës II Botërore, në Teksas, në një shkollë ra zjarr dhe si rezultat humbën jetën më shumë se dyqind fëmijë. Pas luftës, shkolla u rindërtua dhe në të u instalua një fikës zjarri automatik, më modernë që ekzistonte për atë kohë në botë. I gjithë qyteti ndihej i sigurtë me këtë sistem zjarrfikës të instaluar. Njerëzit vizitonin shkollën dhe shikonin teknologjinë e përparuar të sistemit zjarrfikës. Me rritjen e qytetit, u bë e nevojshme që klasa dhe ambjente të reja t'i shtoheshin godinës së shkollës. Duke punuar

për ndërtimin e kësaj shtese, ata zbuluan diçka që i tronditi. Kishin kaluar shtatë vjet që nga ndërtimi i shkollës dhe nga instalimi i fikësit automatik. Megjithatë, u zbulua se fikësi nuk ishte aktivizuar asnjëherë!

E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me një bashkësi. Ndërsa Perëndia u ofron bashkësive lokale fuqi të jashtëzakonshme, ato mund të mos e venë atë asnjëherë në punë. Disa nga anëtarët mund të përpiqen shumë, por megjithatë, shumica rri e bën sehir dhe bashkësia nuk funksionon si një trup, në përputhje me planin e Perëndisë. Ata nuk punojnë së bashku në rrugën e Perëndisë dhe, si rrjedhim,

nuk veprojnë me anë të fuqisë së Perëndisë.

Çfarë mund të bëni në qoftë se jeni në një bashkësi të tillë? Lutuni dhe pastaj lutuni edhe më shumë që Perëndia ta udhëheqë bashkësinë tuaj, në mënyrë që secili prej anëtarëve të ndjejë përgjegjësitë e tij dhe t'i mbajë ato përgjegjësi. Vetëm në këtë mënyrë kisha mund të funksionojë sipas planit të Perëndisë, pra si një trup. Shqyrtoni mundësinë për të qenë më aktiv në bashkësinë tuaj. Flisni për këtë me anëtarët e tjerë të bashkësisë apo me të vjetrit e bashkësisë tuaj, nëse keni të tillë në bashkësinë tuaj. Pastaj vazhdoni të luteni dhe shikoni si vepron Perëndia në bashkësinë tuaj.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: *"Efesianëve"*
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara